

KONTRATË TRANSFERIM KUOTASH (DHURIM)

Sot më datë **07/09/2021** në Tiranë lidhet kjo kontratë transferimi për dhurim kuotash me palët si vijon.

Pala Dhuruese:

Jona Dajçi, e bija e Xhavitit, lindur në Tiranë, më 10/10/1988, banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar e identifikuar me pasaporte me Nr. BA2854884 dhe nr. personal I86010072F.

që në vazhdim të kësaj kontrate do të quhet **Pala Dhuruese**.

Pala Pranuese:

Enida Bogdani, e bija e Agronit, lindur në Tiranë, më 20/09/1988, banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar e identifikuar me Kartë Identiteti me Nr. 037499650 dhe numër personal I85920065F.

Edlira Zaloshnja, e bija e Skenderit, lindur në Tiranë, më 05/07/1988, banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar e identifikuar me Kartë Identiteti me Nr. 034911950 dhe numër personal I85705020V.

që në vazhdim të kësaj kontrate do të quhet **Pala Pranuese**.

Shoqëria "**TRIAD 1988**" Shpk, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore me NIPT **L82428016A** me kapital 1,000 Lekë, me numër të përgjithshëm kuotash 3 dhe vlerë nominale 330.30 lekë, me ortakët si më poshtë:

Pala Dhuruese **Jona Dajçi**, është ortak në masën 33.33% i kuotave të kapitalit, me një vlerë me kapitali 330.30 Lekë, me numër kuotash 1 dhe vlerë nominale 330.30 lekë.

Pala Pranuese **Enida Bogdani**, është ortak në masën 33.33% i kuotave të kapitalit, me një vlerë me kapitali 330.30 Lekë, me numër kuotash 1 dhe vlerë nominale 330.30 lekë.

Pala Pranuese **Edlira Zaloshnja**, është ortak në masën 33.33% i kuotave të kapitalit, me një vlerë me kapitali 330.30 Lekë, me numër kuotash 1 dhe vlerë nominale 330.30 lekë.

Neni 1

Objekti

Pala Dhuruese, **Jona Dajçi**, i dhuron me vullnet të lirë palës pranuese pjesën e tij takuese prej 33.33% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, e barabartë në vlerën

1/2

330.30 Lekë, që zotëron në shoqërinë “**TRIAD 1988**” Shpk e rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore me NIPT **L82428016A**.

Pala Pranuese, **Enida Bogdani** dhe **Edlira Zaloshnja**, me vullnet të lirë dhe të plotë pranojnë prej palës dhuruese **Jona Dajçi** pjesën e saj takuese prej 33.33% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, prej 1 kuotash, e barabartë në vlerën 330.30 Lekë në shoqërinë “**TRIAD 1988**” Shpk e rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore me NIPT **L82428016A** në mënyre të barabartë.

Neni 2

Transferimi i Pronësisë

Me nënshkrimin e kontratës së transferimit (dhurimit) të kuotave të cituara më lart pala dhuruese **Jona Dajçi** zhvishet plotësisht nga pjesa e saj takuese e kapitalit themeltar prej 1 kuote, me një vlerë 330.30 Lekë që gëzon në shoqëri, dhe pala pranuese:

1. **Enida Bogdani** bëhet zotërues e 50% i kapitalit të shoqërisë, baraz me 1 Kuotë, me një vlerë nominale 500 Lekë.
2. **Edlira Zaloshnja** bëhet zotërues e 50% i kapitalit të shoqërisë, baraz me 1 Kuotë, me një vlerë nominale 500 Lekë.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate ortakët e shoqërisë “**TRIAD 1988**” Shpk janë:

1. **Enida Bogdani** zotërues 50% i kapitalit të shoqërisë, baraz me 1 Kuotë, me një vlerë nominale 500 Lekë;
2. **Edlira Zaloshnja** bëhet zotërues 50% i kapitalit të shoqërisë, baraz me 1 Kuotë, me një vlerë nominale 500 Lekë.

Vlera nominale e një kuote pas këtij veprimi ndryshon, nga 330.30 lekë në 500 lekë.

Pala Pranuese merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate dhurimi.

Pala pranuese nuk ka asnjë përgjegjësi për detyrimet që pala dhuruese mund të ketë jashtë shoqërisë.

Neni 3

Të Fundit

Çdo marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Përsa nuk është parashikuar në këtë kontratë, palet i referohen dispozitave të kontratës përkatëse në Kodin Civil.

Kontrata përpilohet në 4 (katër) kopje.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

Jana Dajç
Jef

PALA PRANUESE

Edlira Kaloshmyja
Emida Bagdami